



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 762 Prot.

Tiranë, më datë 24.07.2020

VENDIM

Nr. 232, datë 24.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Impiant trajtimi dhe sistemi i kanalizimit të ujërave të përdorura në zonën turistike Dhërmi”, Bashkia Himarë, kërkesë e shoqërisë “PLAN - CONSULT” dhe raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor realizuar nga personi i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Subjekti duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Impiant trajtimi dhe sistemi i kanalizimit të ujërave të përdorura në zonën turistike Dhërmi” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

